

Ylberza Halili

Rezyme

Përrallat, si një zhanër i rëndësishëm i folklorit, kanë ngjallur interes të konsiderueshëm të studiuesve për shkak të përmbajtjes, motiveve dhe personazheve të shumtë dhe të larmishëm. Struktura e tyre përfshin një gamë të gjerë fenomenesh që kanë kontribuar në kuptimin e elementeve të krijuara nga kultura të ndryshme. Përrallat popullore janë dëshmi e rrëfimeve popullore ndër shekuj nga studiues të ndryshëm, të cilët i mblodhën dhe i klasifikuan përrallat drejtpërdrejt nga burimet gojore. Në kulturën shqiptare, një na mblodhësit dhe arkivuesit e parë të përrallave shqiptare është Atë Donat Kurti, që gjatë mblledhjes dhe botimit të përrallave popullore shqiptare vërejti ngjashmëri, dhe në referencat e tij vuri në dukje se disa nga përrallat e tij mund të krahasohen me përrallat e vëllezërve Grimm, në këtë mënyrë, duke më frymëzuar për analiza dhe krahasime të mëtejshme.

Vëllezërit Grimm janë nismëtarë të teorisë mitologjike, sipas së cilës përrallat trajtohen si mbetje të miteve të lashta të popujve indogjermanë. Në shqyrtimet e ndryshme të vëllezërve Grimm hetohen edhe mendime të tjera, nga dalin edhe dy teori të tjera: ajo e migracionit dhe e poligjenezës.

Së këndejmi, gjatë studimit tonë krahasues ndërmjet përrallave të Atë Donat Kurtit dhe përrallave të vëllezërve Grimm jemi munduar t'u përgjigjemi dy pyetjeve qenësore:

1. Cilët janë elementet që i përbashkojnë këto përralla? Cfarë është karakterisitke te përrallat tona që nuk e gjejmë te përrallat gjermane si dhe anasjelltas?

Punimi është strukturuar në pesë kapituj:

- Letërsia e krahasuar dhe intertekstualiteti
- Çështje të problematikës së formave gojore dhe të klasifikimit të tyre në folklorin shqiptar
- Historia, teoritë dhe klasifikimi i përrallës
- Poetika e përrallës – konteksti, teksti dhe tekstura

- Përrallat e Vëllezërve Grimm dhe përrallat e Atë Donat Kurtit (vështrim krahasimtar)

Në këtë studim, nga metodat e tjera të punës shkencore, si ajo analitike, është përdorur më së shumti metoda krahasimtare e cila ka mundësuar që trajtimin e tematikës së përrallave shqipe ta shohim edhe në krahasim me tematikën e përrallave botërore dhe janë pikasur pika të përbashkëta dhe dalluese në aspektin tematik. Gjithashtu për t'i trajtuar përrallat, jemi mbështetur edhe në teorinë e morfologjisë së përrallës nga studiuesi Vladimir Propp.

Qëllimi i studimeve të tilla krahasimtare është të zbulojë ngjashmëritë, dallimet dhe elementet e përbashkëta për të fituar një kuptim më të thellë të koncepteve universale njerëzore, shkëmbimeve kulturore dhe metodave që shoqëritë përdorin për të përcjellë traditat e tyre. Në studimet krahasimtare, dallimet midis rajoneve nxirren në dritë dhe evidentohen nëpërmjet shqyrtimit të teksteve të ndryshme folklorike. Ky eksplorim shërben për të zbuluar diversitetin e pasur të kulturave dhe mënyrën se si ato formojnë traditat e tyre unike.

Përrallat janë një pjesë e rëndësishme e folklorit tonë sepse përmes tyre njihen besimet, zakonet, dëshirat, frika dhe shqetësimet e njerëzve që në lashtësi. Ato kanë fuqinë për të lidhur popujt dhe shekujt. Përrallat janë universale. Në vendin tonë ka përralla të panjohura dhe të paklasifikueshme. Motivët që zhvillohen tek ne i gjejmë edhe në përrallat e indianëve, arabëve dhe keltëve, por ka edhe nga ato që përkojnë me përrallat greke dhe romake. Prandaj, është me rëndësi që të trajtohen këto forma gojore që janë një trashëgimi e çmuar e popullit tonë që është përcjellë brez pas brezi.

Folklori shpesh konsiderohet si një pasqyrë që shpërfaq grupe të ndryshme të kulturave dhe vlerave morale të popujve. Ky studim i bazuar në rezultatet ekzistuese të kërkimit, krahason dhe shqyrton disa përralla nga kultura perëndimore dhe kultura shqiptare. Gjetjet e hulumtimit tregojnë se ka ngjashmëri dhe dallime të folklorit midis dy sistemeve kulturore.

Doctoral Thesis: Intertextuality in Donat Kurti's folktales

Ylberza Halili

Summary

Folktales, as an important genre of folklore, have aroused considerable interest among researchers due to their numerous and diverse content, motifs and characters. Their structure includes a wide range of phenomena that have contributed to the understanding of the elements created by different cultures. Folk tales are evidence of folk narratives over the centuries by various scholars, who collected and classified the tales directly from oral sources. In Albanian culture, one of the first collectors and archivists of Albanian folktales is Donat Kurti, who during the collection and publication of Albanian folktales noticed similarities, and in his references noted that some of his tales can be compared to the tales of the Brothers Grimm, thus inspiring me for further analysis and comparisons.

The Brothers Grimm are the initiators of the mythological theory, according to which fairy tales are treated as remnants of the ancient myths of the Indo-Germanic peoples. In the various studies of the Brothers Grimm, other opinions are also investigated, from which two other theories emerge: that of migration and that of polygenesis.

Therefore, during our comparative study between the folktales of Donat Kurti and the folktales of the Brothers Grimm, we have tried to answer two essential questions:

1. What are the elements that these fairy tales have in common? What is characteristic of our fairy tales that we do not find in German fairy tales and vice versa?

The paper is structured in five chapters:

- Comparative Literature and Intertextuality
- Issues of the problematic of oral forms and their classification in Albanian folklore

- History, theories and classification of the folktale
- Poetics of the folktale – context, text and texture
- The Brothers Grimm's folktales and the folktales of Donat Kurti (comparative view)

In this study, from other methods of scientific work, such as the analytical one, the comparative method has been used the most, which has enabled us to see the treatment of the theme of Albanian folktales in comparison with the themes of world folktales, and during the study, common and distinctive points have been identified in the thematic aspect. Also, to treat folktales, we have relied on the theory of the morphology of folktale by the folklorist and the scholar Vladimir Propp.

The purpose of such comparative studies is to discover the similarities, differences and common elements to gain a deeper understanding of universal human concepts, cultural exchanges and the methods that societies use to transmit their traditions. In comparative studies, differences between regions are brought to light and evidenced through the examination of different folklore texts. This exploration serves to reveal the rich diversity of cultures and the way they form their unique traditions.

Fairy tales are an important part of our folklore because through them the beliefs, customs, desires, fears and concerns of people since ancient times are known. They have the power to connect peoples and centuries. Fairy tales are universal. In our country there are unknown and unclassifiable fairy tales. The motifs that develop in us are also found in the tales of the Indians, Arabs and Celts, but there are also those that coincide with Greek and Roman fairy tales. Therefore, it is important to treat these oral forms that are a precious heritage of our people that has been passed down from generation to generation.

Folklore is often considered a mirror that reveals different groups of cultures and moral values of peoples. This study, based on existing research results, compares and examines several fairy tales from Western and Albanian cultures. The research findings show that there are similarities and differences in folklore between the two cultural systems.

